



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 25.5.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Doruntinë Maloku dhe Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Valdete Daka- KGJK; Besim Kelmendi-PSRK; Blerta Bejtullahu dhe Behlul Zeka-EUSR/EU Office; Alma Tafarshiku-EULEX; Besim Morina-IGJK; Valdet Hajdini-IKD; Dren Doli dhe Fisnik Korenica-GLPS; Visar Sutaj-KDI; Baki Gimolli-MD; Lekë Batalli-GLPS; Etleva Ikonja- “Kosova Sot”, Kushtirm...- RTV 21; Fitore Hajdini dhe Floriana Merovci –ZPRK; Pranvera Musa- “Kosova Press”, Gjita Lushi- Rrokum TV; Leotrim Gashi – UP, juridik; Petrit Hysaj – OSBE; Agon Gashi – PILPG; Mark Hovon dhe Edita Kusari – EROL; Albert Avdiu- KGJK; Bekim Kodraliu, Sanija Popović dhe Luljeta Krasniqi – OSBE; Margarita Kadriu- deputete; Armend Zenelaj – BIRN; Pajazit Krasniqi-Radio Kosova; Gentiana Dushi, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini- praktikantë në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që të fillohet me shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pasi që deputeti Zemaj, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, ende nuk ka ardhur dhe pritët që të vijë shumë shpejt.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryetarja, tha se pavarësisht se këto projektligje kanë ardhur me procedurë të përshpejtuar, si Komision, kemi bërë përpjekje që të japim kontributin tonë, duke qenë të hapur me të gjitha grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Për atë që kemi mundur, kemi marrë propozimet që na kanë ardhur dhe të njëjtat i kemi përfshirë në këto amendamente. Po ashtu, tha se kemi angazhuar edhe ekspertë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, njëri prej tyre, z. Besim Kelmendi, i cili edhe sot është prezent dhe do ta prezantojë ekspertizën e tij, të dorëzuar edhe në grupe punuese. Kurse eksperti Salih Mekaj, sot nuk është prezent dhe nuk ka qenë në grupe punuese. Amendamentet e propozuara nga grupi punues i keni marrë dhe të njëjtat do t'i nënshtrohen vendimmarrjes në Komision. Ajo propozoi që diskutimet të fokusohen vetëm në çështjet që kanë mbetur si dilema dhe jo për secilin amendament.

Anëtarët e Komisionit, eksperti i angazhuar dhe përfaqësuesit e institucioneve që ishin prezent, diskutuan për nenin 3 të projektligjit, gjegjësisht tek përbërja e Këshillit. Fillimisht, në draftin e propozuar nga Ministria e Drejtësisë, ishte propozuar që kryeprokurori të jetë anëtar, pa të drejtë vote. Kurse në amendamentin e propozuar, kryeprokurori është hequr nga përbërja e Këshillit. Eksperti Besim Kelmendi, tha se sa i përket kryeprokurorit, nëse duhet të jetë anëtar i Këshillit, janë dy mundësi: e para, nëse mbetet anëtar i Këshillit, ai duhet të ketë të drejtë vote ose duhet të hiqet në tërësi, si anëtar i Këshillit. Po ashtu, risi tjetër ishte tek përbërja e Këshillit, se tre anëtarë do të zgjidhen nga Kuvendi dhe atë: një anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, një profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

Kishte mendime se zgjedhja e anëtarëve nga Kuvendi, duhet të bëhet me 2/3 të votave të deputetëve të Kuvendit, e këtij mendimi ishte edhe Albulena Haxhiu.

Eksperti Besim Kelmendi, tha se do të duhej të hiqet përfaqësuesi nga Oda e Avokatëve të Kosovës, sepse kjo paraqet konflikt interesi. Kryetarja tha se e kemi ndaluar me një amendament tjetër se përfaqësuesi që vjen nga Oda Avokatëve të Kosovës, nuk mund të ushtrojë detyrën e avokatit, derisa është anëtar i Këshillit. Kjo e parandalon konfliktin e interesit.

Agim Aliu, tha se sa i përket zgjedhjes së anëtarëve nga Kuvendi, nuk duhet të nisemi me paragjykimë, ngase zgjedhja e anëtarëve nga Kuvendi me 2/3, do të krijojë situata bllokuese. Ishte i mendimit që pasi kemi paraparë kritere për anëtarët e Këshillit, nuk duhet të krijojmë situata bllokuese, por të mbetet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

Selvie Halimi, u pajtua me parafolësin, duke shtuar se duhet të bëjmë ligj që e arrin qëllimin e tij dhe mos të krijojmë situata që një organ kaq të rëndësishëm ta bllokojmë duke ditur rëndësinë që ka në sistem.

Armend Zemaj, në parim, unë jam që Kuvendi mos të zgjedhë asnjë anëtar të Këshillit, por nëse Komisioni vendos që tre anëtarët duhet të zgjidhen nga Kuvendi, e mbështes propozimin që ata duhet të zgjidhen me 61 vota dhe jo me 2/3.

Po ashtu, u diskutua se kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Këshillit, që zgjedhën nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat 3 (tre) vjeçar dhe ishte një pajtim i përgjithshëm se duhet të thuhet: “pa të drejtë rizgjedhje”.

Valdete Daka, tha se sa i përket anëtarit nga Oda e Avokatëve, nuk është bërë zgjidhje e mirë, sa i përket pagesës së tij, sepse nëse ai paguhet nga Këshilli, interesat e kujt i përfaqëson në Këshill? Paga e këtij anëtar duhet të rishikohet dhe të gjendet një alternativë tjetër, e jo të paguhet nga Këshilli. Ndoshta, edhe të hiqet krejt nga përbërja, pasi që nuk është kategori kushtetuese, sikurse është tek Këshilli Gjyqësor.

Besim Kelmendi, u pajtua me parafolësen dhe propozoi që pagesa anëtarit të Odës, të bëhet nga vetë Oda.

Kryetarja tha se në nenin 5A të projektligjit, tek paragrafi 2, kemi dy propozime :

Propozimi 1

“2. Çdo 6 muaj paraqet para publikut një raport të detajuar mbi performancën e bazuar në objektiva konkrete dhe indikatorë të matshëm të Prokurorit të Shtetit dhe nevojat e institucionit të arsyetuar gjerësisht. Një raport të tillë ia dërgon publikisht edhe Kuvendit të Kosovës”.

Propozimi 2

“Kryetari i Këshillit paraqet raporte publike vjetore për performancën, veprimet, kostot dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial”.

Propozimi i parë, ka qenë i Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe propozimi i dytë është nga Zyra e BE-së. Personalisht, jam që të kemi një lidhje në mes të Këshillit Prokurorial dhe Kuvendit dhe kjo për arsye se i dini skandalet e fundit që kanë ndodhur në Këshill.

Fisnik Korenica, tha se ne kemi hequr dorë atë ditë në grup punues nga një pjesë e këtij propozimi, me të cilin është pajtuar edhe Zyra e BE-së. Tani mbetet tek ju, nëse doni që një raport të tillë, do ta bënit detyrim që Këshilli t’ia dërgojë Kuvendit, dhe nëse e dërgon, në çfarë forme, a lejohet diskutim për këtë raport? Propozimi ynë është që edhe nëse lejohet që ky raport të vijë në Kuvend, ai nuk duhet të diskutohet dhe raporti mos të prekë rastet konkrete, të cilat janë nën juridiksionin e Prokurorisë së Shtetit, pasi që një gjë e tillë është në kundërshtim me standardet e Komisionit të Venedikut. Ne nuk insistojmë që raporti domosdo të vijë në Kuvend.

Ne, thjesht e kemi bërë një propozim më të zbutur, krahasuar me propozimin që ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë.

Blerta Bejtullahu, tha se Zyra e BE-së qëndron pas propozimit të saj, që tashmë e ka dorëzuar.

Pas diskutimeve, Komisioni, me 6 vota për dhe 1 votë kundër, përkrahu propozimin nr. 2, ku thuhet: “Kryetari i Këshillit së paku një herë në vit paraqet raporte publike vjetore për performacën, veprimet, kostot dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial”.

Milena Miliçević, paraqiti vërejtje, sepse nuk i ka amendamentet në gjuhën serbe.

Kryetarija, tha se këtë vërejtje është dashur që ta paraqisni në fillim të mbledhjes, për këtë arsye edhe u lexuan amendamentet një nga një.

Armend Zemaj, tha se këtu jemi të gjithë të barabartë, por deputetja e ka pasur ftesën për secilin mbledhje e grup punues dhe ka mundur të jetë pjesë e tyre dhe do të ishte e njoftuar për secilin propozim, dhe e dini që është punuar me procedura të përsheptuara.

Përfaqësuesi i IGJK-së, duke folur për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, tha se trajnimi duhet të bëhet para emërimit, pasi kjo e rrit cilësinë. Po ashtu, trajnimi fillestar jo detyrues do të çojë në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kjo i jep mundësi Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, që të kenë cilësi, para se ata të vendosin se cilët kandidatë i plotësojnë kriteret. Po ashtu, kjo është edhe në kundërshtim me Kushtetutën, sepse kriteret kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përveç veprës penale, është edhe moskryerja e detyrave të punës. Në këtë rast, a do të ketë mundësi që një kandidat të shkarkohet, nëse vlerësimi i Komisionit bëhet pas trajnimit?

Valdete Daka, duke u ndërlidhur me parafolësin, ishte e mendimit që edhe sipas Kushtetutës, gjyqtarët dhe prokurorët i rekruton Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, dhe jo Instituti, sepse deri më tani, në një farë mënyre, nga Instituti Gjyqësor janë zgjedhur kandidatë që nuk ka qenë e implikuar fare KGJK-ja dhe KPK-ja. Andaj, konsiderojmë se kjo praktikë duhet të ndërpritet, pasi që ne duhet të jemi ata që duhet t'i rekrutojmë kandidatët.

Më tutje, Komisioni vazhdoi me diskutimin për nenin 18 të projektligjit dhe për këtë nen grupi punues kishte propozuar këtë amendament:

- “1. Vendimet e Këshillit janë përfundimtare dhe ndaj tyre mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit.
2. Gjykata Supreme do të vendosë në shkallë të parë, në kolegji të përbërë prej tre gjyqtarëve, në afat prej 30 ditësh nga marrja e ankesës.
3. Kundër vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Supreme mund të paraqitet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga marrja e vendimit, seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme, e cila duhet të vendosë në një afat prej 30 ditësh nga pranimi i ankesës”.

Kundër këtij propozimi ishte Zyra e BE-së, e cila kishte rekomanduar që ky nen të hiqet në tërësi.

Komisioni, pas diskutimeve dhe sugjerimeve të dhëna nga eksperti Besim Kelmendi, me qëllim të përafrimit të qëndrimeve, propozoi që kompetenca t'i jepet Gjykatës Themelore dhe formulimi do të ishte:

“1. Vendimet e Këshillit janë përfundimtare dhe ndaj tyre mund të paraqitet padi për hapje të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit.

2. Gjykata Themelore do të vendosë në afat prej 30 ditësh nga pranimi i padisë për hapje të konfliktit administrativ.

3. Kundër vendimit të shkallës së parë mund të paraqitet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit në Gjykatën e Apelit, e cila duhet të vendosë në afat prej 30 ditësh nga pranimi i ankesës”.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit.
- II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit

Armend Zemaj, e paraqiti arsyetimin e raportit me amendamente dhe kërkoi nga anëtarët, që të njëjtat të përkrahen pa ndryshime.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit.
- II. Projektligji për kompensimin e viktimave të krimit dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.

Komisioni vendosi që pikat e mbetura të diskutohen në mbledhjen e radhës, më dt. 26.5.2015, në orën 9:00.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu